

Kronikë nga seanca nr. 6- të e KRD-ës

Shkup, 29.01.2013– Këshilli i Radiodifuzionit (KRD) në mbledhjen e sotshme i shqyrtoi dhe miratoi raportet nga monitorimi i programeve të RADIO KANAL 77, TV Era, dhe TELEVISIONI SONCE transmetuar më datë 18, 19 dhe 20 janar 2013.

KRD vendosi të lëshojë vërtetime për regjistrimin e paketave programore të më poshtme:

– Vërtetim për plotësimin e regjistrimit të paketës programore digjitale nr. 14 të Shoqatës për prodhimin e Tregtisë, Trafikut, mikpritjen dhe shërbimet e prodhimit “МУЛТИМЕДИЈА НЕТБОРК Л” eksport – import Gostivar, me serviset programore VESTI 24 dhe Kanal 5.

– Vërtetim për plotësimin e paketës së regjistruar programore nr. 6-të të Shoqatës për inxhiniering telekomunikimi, softuer, tregti dhe shërbime “ВНН САТ” – Vinicë, me serviset programore Sport Klub, Sport Klub+, Golf Klub, Fishing & Hunting, Ultra dhe Cinema.

Në lidhje me emetimin satelitor të servisit programor të radiodifuzerit regional SHTR TV Era, KRD vendosi TV Er-ës që ti dërgojë ndërmendje se në Republikën e Maqedonisë servisi programor nuk mund të transmetohet jashtë hapësirës për të cilën ka marrë leje për ushtrim të veprimtarisë radiodiffuzive

ose në regjionin e Shkupit, ndërsa për emetimin e sajë në vendet tjera nuk ka pengesa. Njëkohësisht, KRD vendosi të gjithë operatorëve të rrjeteve të komunikimit publik jashtë nga Shkupi tu dërgoje letër se nuk mund ta rriemetojnë servisin programor TV Era.

KRD vendosi të gjithë operatorët e rrjeteve të komunikimit publik ti urdhërojë për ndërprerje të programit në kohë të transmetimit të TV serialit “ Zgjedhja e Larës” – sezoni i dytë për transmetimin në servisin programor televiziv OBN nga Bosnja dhe Hercegovina.

Në lidhje me kërkesën e “ДИГИ ПЛУС МУЛТИМЕДИА” rishqyrtim i ligjshmërisë të ritransmetimit të serviseve programore televizive të arena Sport 1,2,3 dhe 4, KRD erdh në përfundim se nuk ka bazë për ndërhyrje në Këshillin e Radiodifuzionit për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të ngjashme në fushën e radiodifuzionit, ndërsa në baza të tjera për mbrojtje e shënuara në kërkesat duhet duket të informohet Komisioni për mbrojtjen dhe korrupsion të RM-ës, me kërkesë të “ДИГИ ПЛУС МУЛТИМЕДИА”.